




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICËS - OPSTINA KAMENICA	
KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIMET ME QYTETARË	
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 02	Nr./Br./No. 11154
Nr.faq Bil. Sir No. Pg 7	Data Datun Dit. 28/04
KAMENICË - KAMENICA 2026	

Procesverbal me shkrim

Datë: 24.04.2026

Diskutim publik në lidhje për Projekt - Rregulloren (KK) Nr. /2026 për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Në fjalën e tij hyrëse përshendeti të gjithë pjesëmarrësit që iu pergjigjën pozitivisht ftesës për diskutimin. Që ka të bëjë me Draft / rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës dhe vazhdoi fjalën e tij. Fillimisht i njoftoi se nga Kryetari, me vendim përkatës është formuar një grup punues ku e kemi bërë hartimin dhe pas diskutimeve, takimeve për konsultime dhe mendimeve këshillimore dhe pasi kjo draft/rregullore ka kaluar të gjitha fazat tani në fund do e diskutojmë në këtë diskutim publik. Me këtë Rregullore nuk është bërë klasifikimi por vetëm sistematizimi, nëse keni nevojë jashtë këtij diskutimi për të gjitha sqarimet që keni mund t'i dërgoni edhe përmes emailit për sqarime të mëtutjeshme.

Rifat Hajdari - Drejtues i ulët në QPS

Ne fjalën e tij tha se edhe me shkrim edhe përmes kryetarit kemi dhënë vërejtjet tona në lidhje me këtë rregullore. QPS funksionin sipas ligjit për shërbimet sociale ku akoma është në fuqi dhe se ne nuk dim si nxjerret rregullore kur është në fuqi ligji, nëse shuhet institucioni i drejtorit në QPS do të bëjë ankesë në këshill dhe gjykatë.

Desha të them si e komentoni ligjin mbi shërbimin social dhe ju si e komentoni se si mundet kjo rregullore të jetë mbi ligjin për shërbimin social dhe tek organogrami përkatësisht të sekori i ndihmave sociale keni rritur numrin e zyrtarëve dhe keni shkuar të shërbimi ku ka punë më shumë keni larguar puntorë dhe keni dërguar të asistencës pa konsultime paraprake.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Paraprakisht, ju njoftoj se pozita e Drejtorit është drejtues i ulët e barazvlefshme me Pozitën e Udhëheqesit (shefit). Ne si grup punues kemi propozuar që QPS me qenë në vete se bashku me dy sektorë të tjerë, mirëpo nuk ka mundësi me qenë se një sektor me dy Udhëheqësa (shefa). Një shef duhet ti ketë minimum dy puntor për te qenë Sektor në vete, ne edhe pse e kemi ndarë mendimin me qenë QPS -sja por nuk ka mundësi që me qenë ne varesi të saj shërbimi social dhe asistencë sociale, për këtë kemi konsultuar edhe me DMZP, ku kanë theksuar se nuk mund të vazhdohet në këtë mënyrë, dhe se e njëjta duhet të jete e ndare nga QPS. Me një fjale Shefi nuk mundet me qenë Udhëheqës i lartë po vetëm Drejtues i ulët - shërbyes civil, sa i përket detyrave dhe përgjegjësi të gjitha janë të përfshira sipas ligjit.

Rifat Hajdari - Drejtues i ulët në QPS

Si është e mundur të zvoglohet numri i puntorëve dhe gjithashtu ne kemi info nga disa komuna tjera që akoma funksionojnë me drejtor ndërsa në Kamenicë po shuhet pozita e drejtorit.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Nuk është zvogluar numri por është bërë sistemimi i vendeve të punës. Po ju rikujtoj se ju keni status të shërbyesit civil - Udhëheqësit dhe jo Drejtorit. Pozitat e lira vlejnë për të gjithë nëse kemi buxhet varësisht prej kërkesave edhe mund të ndryshojnë.

Durim Biqkaj - Zyrtar ligjor në D.SH.M.S

I kam dy propozime se pari dua të theksoj se mungesa e zyrtarit ligjor në këtë drejtori do të krijonte komplekse sepse për çdo gjë duhet ti drejtohet zyrës ligjore. Ne propozojmë që në vend të titullit zyrtar për shëndetësi të bëhet zyrtar për mbështetje ligjore pikërisht në D.shëndetësi dhe propozimi tjetër pasi që komuna është përfituese e dy projekteve për banim social, propozojmë që në kuadër të kësaj drejtorie të bëhet një vend i punës me titull si zyrtar për banim social.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Fillimisht ne si grup punues kemi parapare Zyrtar mbështetës ligjor në secilin drejtori por Komisioni ka vendosur që Zyrtaret Ligjor me qenë në një grup brenda sektorit ligjor për shkak të volumit të punës sepse edhe pse ka pasë zyrtar ligjor prap për punë juridike kanë ardhur tek Zyra ligjore. Në këtë rast Unë ndaj mendimin që të ketë zyrtar mbështetës ligjor në secilin Drejtori përkatëse, por të tjerët kanë pasur mendim për grup ligjor, dhe se Sektori Ligjor, do të punoj për të gjithë drejtoritë përkatëse dhe Zyrën e

Kryetarit. Ndërsa sa i përket punëve në sektorin e shëndetësisë mendoj se edhe Zyrtari administrative mund të kryej punët administrative në drejtori. Përveq Avokatit komunal që është sistemuar tek Kryetari i Komunës, sa i përket titullit Zyrtar Ligjor duhet me qenë në sektorin ligjor, dhe pas miratimit të kësaj Rregullore për secilin do të ndahen detyrat dhe mund të ndërrohen çdo vit varësishtë nga kerkesat.

Ardita Dërmaku - Drejtoreshë në drejtorinë për buxhet dhe financa

Sa i përket rregullorës së bashkë përgjësimit dhe detyrat në sektorin e buxhetit sa i takon zyrtarit të pasurisë mendoj se duhet të qëndroj në drejtorinë e financave sepse është i lidhur direkt me drejtorinë e financave sepse bënë edhe menaxhimin e pasurisë në sektorin e buxhetit, sa i përket zyrtarit ligjor në si drejtori kemi nevojë për një jurist por nëse mendoni se detyra mund të kryhen prej zyrës ligjore atëherë jemi në rregull.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Sektori ligjor, do të kryej të gjitha punët në secilën Drejtori gjithashtu edhe për vendimet e Kryetarit në përgjithësi. Ndërsa Zyrtarin e pasurisë e kemi planifikuar të jete tek sektori i financave mirëpo kur kemi mbajtur takim me DMZP, na është rekomanduar që e njëjta të parashihet tek Drejtoria e Përgjithshëm Administrativ, konkretisht Sektori i shërbimeve të përgjithshme, e cila do të kryej punë për gjithë komunën.

Sami Morina - Përgjegjës i sektorit në DSHPAIE

Sa i përket Drejtorisë, të shërbimeve publike tek detyrat dhe përgjësimit mendoj se ka përzirje të kompetencave dhe të puntorët ka pak përzirje të sektori i shërbimeve publike.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

E kemi trashëguar kështu siq është dhe tani jemi tu e bo sistemimin, në të kaluarën ka pasur sektor që janë në organogramë por në rregullore nuk kanë qenë të përfshirë. të ndarja e detyrave nuk e mohoj se mund të ketë probleme apo paqartësi mirëpo për të gjitha këto mundëni të drejtoheni përmes emailit.

Nazmije Demolli - Kordinatore e njësisë komunale për të drejtat e njeriut

Desha të ndërlihem të fusha e drejtave të njeriut në kuadër të që është paraprë të jetë se bashku me zyrën e integriteteve europiane në praktikën e komunave tjera me sa di unë nuk ka raste të tilla sepse ndryshojnë dhe janë dy fusha të ndryshme njëra me tjetrën mundëni me marrë modelin e Gjilanit se si e ka bërë rregullimin, njësi komunale për të drejtat e njeriut do të dëmtohet por që se bëhen bashkë me zyrën për integritete europiane.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Me sa e di unë me rregulloren paraprake nuk keni qenë njësi si sektor në veti, për shkak të puntorëve detyrat janë të njejta si tek integrimet si tek të drejtat e njeriut, në këtë rastë misioni është i përbashkët. Nuk i mohon të drejtat që derivojnë sipas ligjit, dhe se të gjithë jemi të obliguar që mos të ketë diskriminim.

Edhe njeher po e sqaroje se për çdo pozistë apo sektor duhet të kemi mbulesë - mjete buxhetore që në këtë draft rregullore të parashohim dicka. Ne e kemi marrë konfirmim buxhetor nga DBF dhe gjithashtu kanë njoftuar se jemi në rregull, sa i përketë sistematizimin si në këtë draft/ rregullore.

Nazmije Demolli – Kordinatore e njësisë komunale për të drejtat e njeriut

Pse mu përsërit dy herë pozita zyrtar për të drejtat e njeriut pse mos me qenë e vecantë barazia gjinore po mu bashku këto dyja së bashku.

Shuajb Lakna – U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Detyrat që i kryen kanë me qenë detyra të cilat përcaktohen tek përshkrimi i detyrave, por propozimin mundesh ta dorëzosh dhe do diskutojmë, tek pjesa e juaj është fuzionim i sektorit dhe detyrat do të ndahen për secilin sipas ligjit .

Almedina Kryeziu- Spahiu – Zyrtare në drejtorinë e bujqësisë

- A mundem ta di se si është bërë sistematizimi i vendeve të punës në drejtorinë tonë sepse sipas rregullores sistematizimi duhet të jetë bërë ndryshe, dua ta di arsyen për këtë vendim sepse në komunat e tjera e njejta pozitë është paraparë si specialist.

Shuajb Lakna – U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Ju keni vetëm akt emërim si zyrtare e bujqësisë, DMZP-ja ka dhënë mendim se zyrtari për bujqësi dhe për prodhimtari me qenë qysh ka qenë profesional 2, arsyetimet i kanë dhënë në bazë të rregullores e ke katalogun e vendeve të punës e ke klasifikimin si dhe detyrat e punës, pjesa tjetër sa i përketë Ankesave, ju keni të drejtën e ankesës dhe mundeni t'i parashtroni. Ligji për zyrtar publik i përcakton se kujt t'i drejtoheni dhe se çdo marrëdhënie pune ka adresë ankese.

Bedrije Bajrami – Kordinatore e Bibliotekës

Unë e kam dorëzuar kërkesën time me shkrim por kam një pyetje kjo që jemi duke i diskutuar a do merren parasysh apo jo, kam pyetje për bibliotekën e qytetit tim ku jeni bazuar për ta kthyer në njësi të thjeshtë bibliotekën në cka jeni bazuar dhe e keni degraduar në atë formë .

Shuajb Lakna – U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Nuk kemi bërë klasifikim por sistematizim, ministria juve Konkretisht ju ka ekuevalientu në atë pjesë.

Bedrije Bajrami – Kordinatore e Bibliotekës

Biblioteka nuk duhet të shkojë si institucion në veti edhe është e padrejtë që bibliotekës me iu heqë pavarësisa dhe mu kthij në njësi e thjeshtë në kuadër të drejtorisë kulturore , ju nga pozita udhëheqëse e keni lënë vetëm një bibliotikist sepse nuk ka mundësi një bibliotikist mi kry të gjitha detyrat dhe përgjegjësit dhe është e pamundur të funksionojë kështu.

Shuajb Lakna – U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Parimisht, po e citoj për tu bërë një sektor duhet të ketë mjete buxhetore, t'i ketë sepaku dy zyrtarë, me sa edi unë tek ju shumica prej juve Bibliotekistve janë me Arsim. ky draft ndoshta ka edhe nevojë për ndryshime për atë edhe jemi duke diskutuar ne. Juve ju ka Ekuivalentuar në këtë pozite Ministria, keni të drejtën e juaj që të paraqitni Ankesa, në instanca të tjera, klasifikimi është bërë nga ministria.

Bedrije Bajrami – Kordinatore e Bibliotekës

Kufuzimi buxhetor nuk jep të drejtë të shuhet një institucion sepse komunës mund të i rritet buxheti ndërsa në momentin që shuhet njëherë nuk mund të kthehet. Duhet ti parashohim senet që ndodhin pas 10 viteve jo tash për tash.

Shuajb Lakna – U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Buxhetin e komunës, e bënë DBF në koordinim me Kryetarin. Ne e zbatojmë ashtu siq është dhe nuk mundet me u zbatu diçka që nuk parshihet. Ju jeni me titull kordinatore e që ne ekuivalenc i bie me zyrtarin e lartë, mirpo te pjesa e ekuivalentimit Ministria e ka percaktu sic është në rregulloren që jemi duke diskutuar.

Bedrije Bajrami – Kordinatore e Bibliotekës

Ju kam dorëzuar me shkrim merrni lexoni analizoni janë të specifikuarë të gjitha një nga një sepse mund të mbyllet edhe biblioteka sepse i kemi humbur kompetencat, në momentin që e kthen në njësi të thjeshtë i keni humbur kompetencat.

Shuajb Lakna – U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Do ti shqyrtojmë të gjitha, nuk është përfundimtari dhe as më i miri prandaj edhe jemi duke e diskutuar në këtë takim dhe jeni të lirë që çfardo paknaqësie apo paqartësi te diskutojmë.

Arsim Dërmaku – Zyrtar i arkivës



I njeti problem është te arkivi, arkivi ekziston nga 2006 dhe është themelur me vendim komunal ku përfshihen të gjitha në rregullore tash e kam parë se nuk do të funksionojë më si një sektor, momentin që ju keni parë që arkivi do të transferohet në drejtori të administratës ku do të leni materialet.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Ne bazë të ligjit për arkiva neni 8 par 2, 2.1 arkivat ndërkomunal janë arkivi i Gjilanit dhe si fond krijues përfshihen në këto komuna Gjilan, Kamenic, Viti, Novbërd etj, fond krijues është kur krijohen arkivat vetanake dhe i menaxhojnë ato. Ne nuk kemi shuar asgjë të kjo rregullore ju keni detyrat dhe përgjegjësit akoma .

Arsim Dërmaku - Zyrtar i arkivës

Ju me këë qasje po thoni se nuk duhet të ketë arkiv hiq komuna, arkivi historik komunal nuk është i barabartë.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Propozoj që të shikoni ligjin dhe do e shihni vet.

Arsim Dërmaku - Zyrtar i arkivës

Në këtë formë arkivi nuk është i barabartë me arkivat e tjerë, në këtë formë nuk keni edhe ku të dorëzoni dokumentat.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Ne DAP, te sektori për administrimin e dokumenteve, ku bene pjese zyrtari për arkive Detyrat dhe përgjegjësit i keni të cekuara.

Arsim Dërmaku - Zyrtar i arkivës

Arkivi në këtë formë mund të shuhet dhe duhet të shikohen këto rrethana edhe njëherë.

Burbuqe Leka - Drejtoreshë në DPKGJ

Dua të shprehë shqetësimin tim në këtë projekt përkatësisht në sektorin e kadastrit janë të parapara 6 pozita tash i kemi 7 zyrtar ,tash njërin zyrtar kemi me dërgu në gjeodezi në këtë sektor kështu që propozoj ta parashohum edhe një pozitë tjetër në sektorin e kadastrit shqetësimi im është se agjensioni nuk e lejon këtë pozitë të ketë zyrtar me periudhë afashkurtër duhet të kemi zyrtar me periudhë afagjate dhe nuk mundemi me funksionu me vet alternativë.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Gjeodezia do të kryej të gjitha punet për krejt komunën për investime kapitale per juve dhe per urbanizem te pjesa juve ju jeni të barabartë me pozitat e cekura shtimi i numrit nuk paraqet problem me këtë rregullore pjesa tjetër te numri te dispozitat kalimtare numri nuk e ndryshon rregulloren.

Burbuqe Leka - Drejtoreshe në DPKGJ

Personi që do tranferohet në gjeodezi ne jemi mangut sepse tek ne ska kush ti kryeje këto sherbimë, me kontratë mbi veper nuk mundet askush ti kryeje këto pune .

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore


E di që jeni Drejtori e ngarkuar por besoj se do t'i zvoglojme dhe rregullojmë të gjitha këto probleme.

Shuajb Lakna - U.D i njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore

Si përfundim, cdo ankesë e keni një organ ku mundeni mu u drejtu, për sherbyesit publik është komisioni komunal për ankesa ndërsa për sherbyesit civil është KPMSHCK.

Procesmbajtës:

Enis Fazliu





Lista e pjesëmarrjes në diskutimin publik për Projekt – Rregulloren (KK) Nr. /2026
për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Kamenicës

Data: 24.04.2026

Ora: 09:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1.	Arifet Hajdemi	Q.P.S.	<i>[Signature]</i>
2.	FATON BIRKAS	QPS	<i>[Signature]</i>
3.	Elvir Moroca	DSHMS	<i>[Signature]</i>
4.	Durim Rishaj	DSHMS	<i>[Signature]</i>
5.	Naimë D. Kashti	K. NJKDN	<i>[Signature]</i>
6.	Violeta Krasnigj	DAP	<i>[Signature]</i>
7.	Shehat Rrudhani	DKRS	<i>[Signature]</i>
8.	Arifim Dëshmorci	DKRS	<i>[Signature]</i>
9.	BEDRIJE BAJRAMI	DKRS	<i>[Signature]</i>
10.	Alban Hoxhoni	ZK	<i>[Signature]</i>
11.	ISMET AHMETI	Z.K.	<i>[Signature]</i>
12.	Mirza Jermi	DSHPAIE	<i>[Signature]</i>
13.	Sami Moroca	DSHPAIE	<i>[Signature]</i>
14.	Serdor Bujku	DBPZAR	<i>[Signature]</i>
15.	Bujar Kastrati	D.F.B	<i>[Signature]</i>
16.	Edvin Haxhi	Z.P.B	<i>[Signature]</i>
17.	Driton Syta	DPKGA	<i>[Signature]</i>
18.	Arif Skerri	DUPA - i	<i>[Signature]</i>
19.	Agnesa Krasnigj	Zyra e probacionit	<i>[Signature]</i>
20.	ARMEND RAYEGLI	DBPZHR	<i>[Signature]</i>

SPAHIL

21.	Kaltrina Kadriu	DBPZHR	
22.	Dendra Karibuh	DZHEU	
23.	Bektes Dismulen	DBPZHR	
24.	Vigan Meka	Z. Prokurimit	
25.	Ilirida Zubaku	Kadaster	
26.	Diellza Ferhanaj	ZK	
27.	Vjollca Azemi	DFB	
28.	Monona Grabovci	ZK	
29.	HERITA KRYEZIU	DFB	
30.	Almira Spahiu Begiraj	DFB	
31.	Florentina Kryeziu Dermaku	DSHPAI	
32.	Elma Krivaga	Praktikante	
33.	HYSEN KRIVAN	NERWACHENITO	
34.	Milzimm LIMONI	DKRS	
35.	Florim Demolli	DAP	
36.	Burbunge Leka	DPGJK	
37.	BRONDA DORMACI	DFB	
38.	Arbinda Sejdiu	DAP	
39.	Syhana Kasumi Hotifaj	OGJKP	
40.	Voldete Berisha	Z.1	
41.	AZENING MALIAI	DKRS	
42.	Blerim Marinzi	DIK	
43.	VAXHIA REXHEPA	ZK	
44.	VISAR DEENAKU	DKA	
45.	Foston Hajmizi		
46.	Arifim Dervishi	DKRS	
47.	Juan Boschuku	ZNA & KATEGORIA	
48.	ENIS FAELIU	ZK	
49.			